



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 47, datë 28.02.2023

PËR
MIRATIMIN E MANDATIT TË ANËTARES SË KËSHILLIT BASHKIAK
ZJ. TICJANA PETRAQ VERORI

Në mbështetje të nenit 113, pika 1 dhe 2, të Pjesës së Gjashtë “Qeverisja Vendore” e ligjit nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” e ndryshuar, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, gërma “b”, nenit 49, pika 1 dhe pika 2, nenit 50, nenit 54, pika “j”, nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, të Rregullores së Funksiomit të Këshillit Bashkiak, shkresës të Komisionit Qëndror Zgjedhor me nr.prot 718, datë 09.02.2023, protokolluar me tonën nr.1589/1 prot., datë 10.02.2023, mbështetur në raportin e Komisionit të Mandateve si dhe pas betimit në Këshillin Bashkiak Durrës, në mbledhjen e datës 28.02.2023,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e mandatit të anëtares së Këshillit Bashkiak Durrës, kandidate në listën shumemërore të Partisë Demokratia Sociale të Shqipërisë, zj. Ticjana Petraq Verori.
2. Zj. Ticjana Petraq Verori emërohet në Komisionin e Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor si zëvendësuese e z.Nazmi Bodlli.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Sekretari Këshillit Bashkiak.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 02.03.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 166/prot.
3

Durrës, më 13 03 .2023

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit



**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 47 datë 28.02.2023
“Për miratimin e mandatit të anëtares së Këshillit Bashkiak Znj. Ticjana Petraq Verori”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016
“Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.
Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILIAN JANI

